



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Projekt

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETAREVE TË KZAZ-VE NR.20, NR.36, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirimimin dhe emërimin kryesisht të sekretareve të KZAZ-ve nr.20, nr.36, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Me shkresën nr. 12334 prot., datë 26.06.2019, sekretarja e KZAZ nr. 20, zj. Arkida Doku, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin nr. 141, datë 09.04.2019 për arsye objektive ka kërkuar dorëheqjen.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me vendbanim në Bashkinë Krujë.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se shtetasi Fatbardh Meça, me vendbanim në Bashkinë Krujë, dhe arsim juridik, plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për tu emëruar sekretar i KZAZ nr. 20.

Z.Erald Ismaili i emeruar sekretar kryesisht i KZAZ nr.36 me, vendimin nr 863 date 25.06.2019, ka dhene doreheqjen. Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së,

Nr. 880 i Vendimit Data 26.06.2019 e Vendimit Ora 14:00 e Vendimit

Për lirimimin dhe emërimin kryesisht të sekretareve të KZAZ-ve nr.20, nr.36, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se shtetasi Blendi Bimbli, me vendbanim në Bashkinë Tiranë, dhe arsim juridik, plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për tu emëruar sekretar i KZAZ nr. 36.

Kandidatura si më sipër plotëson vendin vakant në KZAZ-në nr.36, Bashkia Tiranë, nga komunikimi paraprak me kete shtetase, është deklaruar se është dakort të ushrojë detyrën vetëm në territorin e ZAZ-së ku ka vendbanimin.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

